



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 5148 Prot.

Vau Dejes me 30. 09 .2022

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Mllojë ( të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

**Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.211 ha për mbarështimin e flores së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme në ekonominë pyjore Gomsiqe.**

( Paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **26.10.2022. ora 10.00** fshati Mllojë, Njësia Administrative Vau Dejës.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

([info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al) , [ardian.celepija@vaudejes.gov.al](mailto:ardian.celepija@vaudejes.gov.al) , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës ).

**SEKRETARI KËSHILLIT**

**Ardian ÇELEPIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT  
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 27, datë 31 .08 .2022

**“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.211 ha “Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”. në ekonomine pyjore Gomsiqe .**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” ,i propozojmë *Këshillit të Bashkisë Vau Dejës*, ku në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2022 të *Këshillit të Bashkisë* të:

V E N D O S I

- 1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 1.211 ha “Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, në ngastrtrar nr.16;17 të ekonominë pyjore Gomsiqe.
- 2.Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet me të drejtë rinovimi .
- 3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

KRYETARI  
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**  
**Spektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vau Dejës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**RELACION**

**Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjitnr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e(l) , neni 18 pika 2 , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

***Siperfaqja e marrë në studim, pas miratimit në Këshillin Bashkiak do të nështrohet procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.***

**Siperfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 1.211 ha dhe bën pjese në ngastrën nr.16 në sipërfaqe prej 0.1525 ha dhe në ngastrën 17 sipërfaqe prej 1.0585 ha , ekonomia pyjore Gomsiqe.**

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,Shtojca 1,pikat pika 3/1 dhe 3/2, **si me poshtë.**

<b>3. Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme .”.</b>				
Nr.	Përdorimi i territorit	Siperfaqia e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
		1 vit	2- 5 vjet	<b>6-10 vjet</b>
1	Pyll cungishte	23,760	22,770	19,800
2	Pyll shkurre	23,760	22,770	19,800
3	Tokë me Bimësi pyjore, djerr ,Inproduktive	19,800	18,975	13,200

**Afati i dhenies me qira do të jetë 10 vjet.**

**Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik, është 23,977.8 (njëzete tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë eshtatë pikë tetë) lekë në vit.**

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes prej 1.211 ha **Për Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme”.**

**Bashkëlidhur po ju dërgojmë.**

**1.Dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomisë.**

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

**Grupi i Punës**

**Ing.Mark Suli**



**Ing.Zeqir Ujka**



**Ing. Esmeraldo Harapi**



**Miratoi**

**Drejtori**

**Rrok Ftoni**



**RAPORT**

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI  
PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS**

**“Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” .**

Bazuar në **Urdhërin nr.5**, datë 12.01.2022 të Kryetarit të Bashkise për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)”, Grupi i punës i përbërë nga z. Zeqir Ujka Përgjegjës i sektorit të pyjeve z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve ,z. Esmeraldo Harapi specialist kadastrë, nga data **25.08.2022** deri në datën **26.08.2022** beri studimin tekniko-ekonomik dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullësore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore **1.211 ha** “**Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**” . Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullësor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive, rezulton që sipërfaqja e propozuar për tu dhënë me qira është **1.211 ha** dhe bën pjese në **ngastren nr.16 në sipërfaqe prej 0.1525 ha dhe në ngastrën 17 në sipërfaqe prej 1.0585 ha** , ekonomia pyjore **Gomsiqe**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47**, janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur)*.

Ndërhyrjet e propozuara do të jepen në përdorim për një afat **10 vjet** një sipërfaqe prej **1.211 ha** **Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**” .

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”. Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” pika nr 2 germa (a) dhe 7.

**Siperfaqja e marrë në studim, pas miratimit në Këshillin Bashkiak do të nështrohet procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.**

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për pregatitjen e dokumentave të ankandit nepermjet procedurës së kunkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-venë nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pika pikat 3/1 e 3/2, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. **Shuma në lekë/vit konsiston në:**

**1. Vlerën e përdorimit lekë/ha/vit Për Mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, është si më poshtë:**

1. Ngastra nr .16 Cungishte **0.1525** ha x 19,800 lekë = **3,019.5** lekë në vit
2. Ngastra nr .17 ,shkurre 1.0585 ha x 19,800 lekë = **20,958.3** lekë më vit

**Në total lekë 23,977.8 në vit.**

**PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK**

Ing. Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



Ing. Esmeraldo Harapi



**KRYETARI**

**MARK BABANI**



**Bashkia Vau Dejës**

**PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR**

( sipas regjistrimit kadastral)

**Për Mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**

Formulari nr.1

ID. Prone	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksioni	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH29 0 016	Gomsiqe	16	33.52	frasher	prodhues	cungishte	16	0.4	3	2	0	0	N	4.47	150
SH29 0 017	Gomsiqe.	17	24.47	shkurre tjera	prodhues	shkurre	16	0.3	2	2	0	0	N	0.81	20
<b>Gjithsejt</b>			33.52				0	0	0	0	0	0	0	0	0

**PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR**

( sipas verifikimit ne terren)

**Për Mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**

Formulari 2

ID. Prone	Ekonomia	Parcela	Sip.Tot.	Perberja grumbullit	Funksion	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH29 0 016	Gomsiqe	16	33.52	frasher	prodhues	cungishte	24	0.4	4	3	0	0	N	10.4	350
SH29 0 017	Gomsiqe	17	24.47	shkurre tjera	prodhues	shkurre	24	0.3	3	2	0	0	N	2	50
<b>Gjithsejt</b>			57.99				0	0	0	0	0	0	0	0	400

**PLOTESOI:**

Ing. Mark-Suli



Ing. Zeqir-Ujka



Ing. Esmeraldo Harapi



Bashkia Vau Dejës

**TABELA PERMBLEDHËSE E VLËRESIMIT FINANCIAR**  
**Për Mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**

Formulari nr.4

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m <sup>3</sup> sipas asortimente ve	Sasia	Vlera Leke /m3	Shuma I	Gjatesia e perdorimit rruge ne km			Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit			Shuma II	Totali I+II
							1	2.-5	8	9	10	6.-10		
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12		
Pyll Cung.	0.1525	V.Dejës	0	0	0	0	0	23,760	22,770	19,800	3,019.50	3,019.50		
Pyll shkurre	1.0585	V.Dejës	0	0	0	0	0	23,760	22,770	19,800	20,958.30	20,958.30		
Gjuetia	0	V.Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
Invest	0	V.Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
<b>Gjithsejt</b>	<b>1.211</b>										<b>23,977.80</b>	<b>23,977.80</b>		

**LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM**  
**Për Mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme**

Formularin 5

Nr.	ID Prone	Ekonomia Pyjore/kullosore	Ng/neng.nr	Siperfaqje qe hiqet nga fondi pyjor/kullorosor	Siperfaqja Gjatesia ne perdorim km			Tubacion/kanal
					Siperfaqje qe jepet ne perdorim	Rruge km	Linje	
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	SH29 0 016	Gomsiqe	16	0	0.1525	0	0	0
2	SH29 0 017	Gomsiqe	17	0	1.0585			
<b>Shuma</b>					<b>1.211</b>			

**PLOTESOI:**

Ing.Mark Suli



Ing.Zeqir Ujka




Ing.Esmeraldo Harapi





# Ekonomia Pyjore Gomsqje SH 1:10 000



Koordinatat Sistemi Alb 1986, Gaus Kryger			
Nr	X	Y	
1	4390190	4659531	
2	4390281	4659568	
3	4390330	4659447	
4	4390246	4659416	
Ngastra	17	16	
Siperfaqja (m <sup>2</sup> )	10 585	1525	
Sip. totale	12 110		